



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.436/20
441/20
445/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni” – Lipjan, OE “BM Group Sh.p.k” – Prishtinë si dhe ankesës së OE “Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “N.Sh. M.V.R ELEKTROMONTUES” b.i Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, më datën: 05.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni” – Lipjan, OE “BM Group Sh.p.k” – Prishtinë dhe OE “Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni” – Lipjan, OE “BM Group Sh.p.k” – Prishtinë dhe OE “Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK” - Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni” – Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 03.07.2020 me nr.436/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 10, 59, 60, 64, 65, 66, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE “BM Group Sh.p.k” – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 06.07.2020 me nr.441/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 62 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues OE “Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 06.07.2020 me nr.445/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndriqimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures” me nr. të prok: “613-20-1927-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59 dhe nenin 72 të Ligjit për

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 20.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim: Më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE "BM Group SHPK". Pjesa e fakteve e referuar në konstatimet e mëposhtme gjendet në pjesën e 3-të të këtij raporti.

Sa i përket pretendimit të parë ku sipas OE ankues, Autoriteti Kontraktues thotë që "për mjetet e punës (Auto Korpe) librezat e qarkullimit janë me afat të skaduar", Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Libreza e Autokorpes me numër regjistrimi 01-669-HL ka afat deri më datë 22.05.2021. Një dokument i tillë ka validitet deri me datën e lartpërmendur, datë kjo e cila mund të shihet edhe në dokumentet e OE ankues në ofertën e dërguar sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit (shih faktin nr. 1 tek pjesa e 3-të e këtij raporti). Sa i përket pretendimit të dytë ku Autoriteti Kontraktues përmend që "Një librezë e kamionit me kran është modifikuar me data të regjistrimit dhe e pakuptueshme", Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Libreza e qarkullimit e automjetit me numër regjistrimi 01-823-HG mund të shihet edhe në "Listën e dokumenteve" të dërguara nga OE ankues, ku figuron data e validitetit dhe numri i regjistrimit (shih faktin nr. 2 tek pjesa e 3-të e këtij raporti). Për cfarëdo hamendje, Autoriteti Kontraktues ka mundur të thirret në nenin 39 të RRUOPP për të sqaruar, apo të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender konform nenit 72.

Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me eskavatorët, cilindrin për ngjeshje dhe kompresorit për thyerje të pjesëve të forta, gjegjësisht argumentimin e Autoritetit Kontraktues që OE ankues ka ngarkuar vetëm fatura dhe i mungojnë kontratat e shitblerjes, Eksperti shqyrtues vlerëson që këto pretendime janë të pabazuara. Pjesa e FDT-së tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku Autoriteti Kontraktues decidivisht përmend që për automjetet që nuk regjistrohen operatorët ekonomik duhet dorëzuar faturën e blerjes dhe nuk përmendet kontrata e shitblerjes si dokument shtesë, nuk i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që për kërkesa që nuk i ka specifikuar vetë, të argumentojë në favor të këtij të fundit. Një

arsyetim i lartpërmendur bazohet konform nenit 59, paragrafit 4 të LPP-së “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” dhe nenit 41.3 të RRUOPP, tek parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim” Sa i përket pretendimit ku Autoriteti Kontraktues përmend si arsye të diskualifikimit mungesën e dëshmive për burginë hidraulike për shpim për vendosje të shtyllave, Eksperti Shqyrtues argumenton që vlen konstatimi i pretendimit të dytë ku në mungesë të dëshmive dokumentare për mjetin e lartpërmendur, Autoriteti Kontraktues të thirret në dispozitat ligjore relevante. Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “BM Group SHPK” ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë “N.Sh M.V.R.ELEKTROMONTUES” nuk ka ofruar asnjë broshurë apo katalog për produktet e ofertuara përkundër që ka qenë si kusht në paramasë që OE të ofrojë këto të fundit dhe nuk ka ofruar asnjë garancion për produktet e ofertuara “Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar që t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të jenë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikaten e origjinës së materialeve. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallogaritura”, një pretendim i tillë është i bazuar. Duke marrë parasysh paramasën e përgatitur nga vet Autoriteti Kontraktues, ky i fundit për të krijuar uniformitet në vlerësim të njëtrajtshëm të ofertave është dashur të respektojë të gjitha kushtet dhe specifikacionet e paraqitura.

Më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE “FGE ELEKTRO SHPK & NTP TONI-GONI”. Pjesa e fakteve e referuar në konstatimet e mëposhtme gjendet në pjesën e 3-të të këtij raporti Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE të rekomanduar për kontratë i mungon vendimi apo deklarata për emërimin e menaxherit të projektit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE (shiko nenin 9.1& 9.2 Dëshmia 2. pika a), ku pas kërkesës për Shqyrtim nga ana e OE ankues tek AK se në dokumente nuk gjendej menaxheri i projektit në listën e stafit, AK ka derguar sqarim tek OE ankues i lartpërmendur se ka kërkuar nga OE fitues menaxher projektin pasi që nuk ishte në listën e stafit të ofruar, një pretendim i tillë është i bazuar. Në listën e dokumenteve të OE të rekomanduar nuk figuron deklarata për emërim të menaxherit të projektit, sidoqoftë, Autoriteti Kontraktues konform dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së, konkretisht nenit 72 për dokumentacion dhe informata shtesë, ka kërkuar sqarim në pajtim me ligjet në fuqi. Duhet pasur parasysh që cfarëdo sigurim i informacionit që mungon ose ofrim i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Një

paragraf i tillë mbetet nën diskrecionin e Autoritetit Kontraktues të vlerësojë nëse dokumenti apo informacioni shtesë është dorëzuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka përzgjedhur një eskavator dhe një mini eskavator përkundër kërkesave të AK në pikën 9.1 & 9.2 ku janë kërkuar min. 2 eskavatorë, Eksperti Shqyrtues vlerëson që një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Pas shqyrtimit të lëndës, shkresave dhe dokumenteve përcjellëse, mos-specifikimi i Autoritetit Kontraktues mbi tipin dhe madhësinë e automjetit tip eskavator pamundëson ofertim të njëtrajtshëm nga të gjithë operatorët ekonomik. Një interpretim i tillë mund të vërehet edhe në ofertimin e OE të rekomanduar për kontratë, ku pavarësisht ofertimit me mini eskavator në njërin nga automjetet e kërkuara konform dosjes, AK ka marrë si të mirëqenë llojin dhe madhësinë e këtij automjeti.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar tri Auto Korpe sa i përket kërkesës së AK, konkretisht pjesës 9.1 & 9.2 - Auto Korpe (shportë) min 2 copë, ku në bazë të Dokumentit të Qarkullimit shihet qartë se Auto korpa me numër të regjistrimit 01-723-LI dhe 01-561-EN janë me afat të skaduar (shiko 5. Lista e Automjeteve fq.4 dhe 9), një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Validiteti i dokumentit të qarkullimit duhet të përkojë me datën e hapjes, ose datën e fundit për dorëzim të ofertave dhe jo me atë të datës së publikimit të njoftimit për kontratë sic edhe është argumentuar nga AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Edhe këtu, Autoriteti Kontraktues ka mundur të thirret në nenin 72 të LPP-së, duke kërkuar kështu sqarime/dokumentacion shtesë konform rregullave dhe dispozitave ligjore që përfshin kjo dispozitë.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një Kamion Auto Kran ku në bazë të Dokumentit të Qarkullimit shihet qartë se Kamioni nuk është i regjistruar fare nga data 07.11.2019 (shiko 5. Lista e Automjeteve fq.14), Eksperti Shqyrtues e vlerëson pretendimin si të pabazuar. Pas dorëzimit të letrës standarde të kërkesës për sqarim të tenderit drejtuar OE të rekomanduar për kontratë, ky i fundit ka dërguar policën e sigurimit të automjetit me numër regjistrimi 01-143-GT brenda afatave ligjore të parapara me LPP. Duke marrë parasysh faktin që OE ankues përmend argumente shtesë rreth validitetit të policës së sigurimit, dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, mbetet nën diskrecionin dhe përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues të verifikojë dokumentin në fjalë dhe të sigurohet rreth përmbajtjes dhe afatave kohore të lëshimit të këtij dokumenti. Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues për kontratën mbi qiranë për makinë shpimi të datës 19.05.2020, ku OE i rekomanduar për kontratë në nenin 1 të kësaj kontrate ka përkrahur se qiradhënësi i bart qiramarrësit në shfrytëzim Kamionin kiper dhe Makinën e përdorur për shpim horizontal dhe kompresor Ajri , ndersa tek nenin 2 i të njëjtën kontratë thuhet

se afati i shfrytëzimit të makinës shpimi rrjedh nga data 19.05.2019, ndësa kontrata është lidhur më datën 19.05.2020, Eksperti Shqyrtues vlerëson që një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo, për faktin që data e nënshkrimit të marrevëshjes përfshin periudhën e fushëveprimit të aktivitetit të prokurimit nënshkruar nga palët, gjegjësisht qiramarrësit dhe qiradhënësit. Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që lista e pajisjeve nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është nënshkruar po vetëm vulosur, përkundër kërkesave të AK-së që një listë e tillë duhet nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ofertues, Eksperti pas shqyrtimit të lëndës, gjen pretendimin si të bazuar. Pjesa 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në FDT përmend decidivisht që Dëshmia 3 – Lista e pajisjeve duhet nënshkruar dhe vulosur.

Më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE “Risamont ShPK; Gafa Construction SHPK”. Pjesa e fakteve e referuar në konstatimet e mëposhtme gjendet në pjesën e 3-të të këtij raporti

Sa i përket pretendimit ku thuhet nga AK se deklarata nën betim e anëtarit të Konzorciumit tuaj nuk është plotësuar sipas RRUOPP, dhe ka mangësi në plotësimin e saj duke rezultuar kështu në eliminim të OE ankues, një pretendim i tillë është pjesërisht i pabazuar. Marrëveshja e konzorciumit e plotësuar nga grupi i operatorëve ekonomik ankues përmban informatat esensiale të këtij aktiviteti të prokurimit. Sa i përket deklaratave të nënshkruara nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes apo/edhe deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, Autoriteti Kontraktues ka mundur të kërkojë informata shtesë konform RRUOPP dhe nenit 72 dhe 59 të LPP-së.

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund të kërkohej informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Mund të kërkohej informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Mund të kërkohej informata sqaruese	Kusht administrativ

Sa i përket pretendimit ankimor ku Autoriteti Kontraktues thuhet që mungojnë dëshmitë për kompresor për thyerje të pjesëve të forta beton asfalt, dhe nuk janë në bazë të kërkesave të AK, Eksperti Shqyrtues vlerëson

[illegible]

Sa i përket pretendimit ankimor ku Autoriteti Kontraktues thotë që grupit të OE ankues i mungojnë dëshmitë për cilindër për ngjeshje, një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse në ofertën e këtyre të fundit, Eksperti vlerëson që sa i përket cilindrit për ngjeshje, grupi i OE ekonomik ka listuar këtë pajisje në marrëveshjen e bashkëpunimit me OE “Tali SHPK” por nuk ka ofruar dëshmi dokumentare për pajisjen në vecanti.

Faqe 7 nga 15

1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa: 3 Lista e pajisjeve teknike, g) Burgji Hidraulike për shpim vertikal për vendosje te shtyllave min. 1 cope

Në dëshminë e sjellur nga OE i propozuar për kontratë, përshkrimi i produktit është: Vegla për birime në shkëmb apo tokë me pjesën punuese

Burgji për shtylla elektrike/Digmaq.

Kërkesa e AK ishte "g) Burgji Hidraulike për shpim vertikal për vendosje te shtyllave min 1 cope", ndërsa OE ka ofruar një përshkrim krejt tjetër nga ajo i kërkuar nga AK si dhe ka ofruar disa foto të mara nga interneti. (ANEXI 6 dhe ANEXI 7)

Një pretendim i tillë është i pabazuar pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ekziston dëshmia dokumentare (DUD) e cila përshkruan llojin dhe fushëveprimin e pajisjes në fjalë konform kërksave të AK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor të grupit të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë ku thuhet që:

2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 3 Lista e pajisjeve teknike, Cilindër për ngjeshjen (min 1 cope)

Mungon dëshmia e transaksionit bankarë, apo e DUD-it doganorë që e vërteton se cilindri është në pronësi të shitësit, gjithashtu mungon edhe transaksioni bankarë që e dëshmon se pajisja është blerë nga blerësi, respektivisht nga OE i propozuar për kontratë (ANEXI 8)

Një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi që për pajisjen në fjalë ekziston fatura me përshkrim konform kërksave të pajisjes në fjalë. Në rast të paqartësive rreth pronësisë së pajisjes, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të kërkojë dokumente mbështetëse konform dispozitave ligjore në fuqi.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues i sheh ankesat e operatorëve ekonomik ankues si pjesërisht të bazuara, duke sugjeruar kështu që njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndricimi publik në Medvec dhe Vrell të Magures" me nr. të prokurimit: 613-20-1927-5-2-1, aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Lipjan, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues duhet të jenë: pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.07.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo i njejt nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik "FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni" – Lipjan, me datë: 20.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "BM Group Sh.p.k" – Prishtinë, me datë: 20.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK" - Prishtinë, me datë: 20.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE "BM Group SHPK".

Lidhur me pretendimin e parë ku sipas OE ankues, Autoriteti Kontraktues thotë që "për mjetet e punës (Auto Korpe) librezat e qarkullimit janë me afat të skaduar". Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Libreza e Autokorpes me numër regjistrimi 01-669-HL ka afat deri më datë 22.05.2021. Një dokument i tillë ka validitet deri me datën e lartpërmendur, datë kjo e cila mund të shihet edhe në dokumentet e OE ankues në ofertën e dërguar sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit (shih faktin nr. 1 tek pjesa e 3-të e j raportit të ekspertizës).

Lidhur me pretendimin e dytë të ankuesit ku pretendon se Autoriteti Kontraktues përmend që "Një librezë e kamionit me kran është modifikuar me data të regjistrimit dhe e pakuptueshme", paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse, e gjen pretendimin si të pabazuar. Libreza e qarkullimit e automjetit me numër regjistrimi 01-823-HG mund të shihet edhe në "Listën

e dokumenteve” të dërguara nga OE ankues, ku figuron data e validitetit dhe numri i regjistrimit (shih faktin nr. 2 tek pjesa e 3-të e raportit të ekspertizës). Për çfarëdo hamendje, Autoriteti Kontraktues ka mundur të thirret në nenin 39 të RRUOPP për të sqaruar, apo të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që nderlidhet me eskavatorët, cilindrin për ngjeshje dhe kompresorit për thyerje të pjesëve të forta, gjegjësisht argumentimin e Autoritetit Kontraktues që OE ankues ka ngarkuar vetëm fatura dhe i mungojnë kontratat e shitblerjes. Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues vlerëson që këto pretendime janë të pabazuara. Pjesa e FDT-së tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku Autoriteti Kontraktues decidivisht përmend që për automjetet që nuk regjistrohen operatorët ekonomik duhet dorëzuar faturën e blerjes dhe nuk përmendet kontrata e shitblerjes si dokument shtesë, nuk i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që për kërkesa që nuk i ka specifikuar vetë, të argumentojë në favor të këtij të fundit. Një arsyetim i lartpërmendur bazohet konform nenit 59, paragrafit 4 të LPP-së “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” dhe nenit 41.3 të RRUOPP, tek parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së “Vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ku Autoriteti Kontraktues përmend si arsye të diskualifikimit mungesën e dëshmive për burginë hidraulike për shpim për vendosje të shtyllave. Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues argumenton që vlen konstatimi i pretendimit të dytë ku në mungesë të dëshmive dokumentare për mjetin e lartpërmendur, Autoriteti Kontraktues të thirret në dispozitat ligjore relevante.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “BM Group SHPK” ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë “N.Sh M.V.R.ELEKTROMONTUES” nuk ka ofruar asnjë broshurë apo katalog për produktet e ofertuara përkundër që ka qenë si kusht në paramasë që OE të ofrojë këto të fundit dhe nuk ka ofruar asnjë garancion për produktet e ofertuara “Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar që t’i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të jenë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikatën e origjinës së materialeve. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallogaritura”. Paneli

shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është i bazuar. Duke marrë parasysh paramasën e përgatitur nga vet Autoriteti Kontraktues, ky i fundit për të krijuar uniformitet në vlerësim të njëtrajtshëm të ofertave është dashur të respektojë të gjitha kushtet dhe specifikacionet e paraqitura.

Paneli shqyrtues kondorm ekspertiti shqyrtues sqaron se më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE "FGE ELEKTRO SHPK & NTP TONI-GONI".

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet që OE të rekomanduar për kontratë i mungon vendimi apo deklarata për emërimin e menaxherit të projektit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE (shiko nenin 9.1& 9.2 Dëshmia 2. pika a), ku pas kërkesës për Shqyrtim nga ana e OE ankues tek AK se në dokumente nuk gjendej menaxheri i projektit në listën e stafit, AK ka derguar sqarim tek OE ankues i lartpërmendur se ka kërkuar nga OE fitues menaxher projektin pasi qe nuk ishte ne listën e stafit të ofruar. Paneli shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është i bazuar. Në listën e dokumenteve të OE të rekomanduar nuk figuron deklarata për emërim të menaxherit të projektit, sidoqoftë, Autoriteti Kontraktues konform dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së, konkretisht nenit 72 për dokumentacion dhe informata shtesë, ka kërkuar sqarim në pajtim me ligjet në fuqi. Duhet pasur parasysh që çfarëdo sigurim i informacionit qe mungon ose ofrim i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Një paragraf i tillë mbetet nën diskrecionin e Autoritetit Kontraktues të vlerësojë nëse dokumenti apo informacioni shtesë është dorëzuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka përzgjedhur një eskavator dhe një mini eskavator përkundër kërkesave të AK në pikën 9.1 & 9.2 ku janë kërkuar min. 2 eskavatorë. Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues vlerëson që një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Pas shqyrtimit të lëndës, shkresave dhe dokumenteve përcjellëse, mos-specifikimi i Autoritetit Kontraktues mbi tipin dhe madhësinë e automjetit tip eskavator pamundëson ofertim të njëtrajtshëm nga të gjithë operatorët ekonomik. Një interpretim i tillë mund të vërehet edhe në ofertimin e OE të rekomanduar për kontratë, ku pavarësisht ofertimit me mini eskavator në njërën nga automjetet e kërkuara konform dosjes, AK ka marrë si të mirëqenë llojin dhe madhësinë e këtij automjeti.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar tri Auto Korpe sa i përket kërkesës së AK, konkretisht pjesës 9.1 & 9.2 - Auto Korpe (shportë) min 2 copë, ku në bazë të Dokumentit të Qarkullimit shihet qartë se Auto korpa me numër të regjistrimit 01-723-LI dhe 01-561-EN janë me afat të skaduar (shiko 5. Lista e Automjeteve fq.4 dhe 9), paneli shqyrtues konform ekspertiti

shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Validiteti i dokumentit të qarkullimit duhet të përkojë me datën e hapjes, ose datën e fundit për dorëzim të ofertave dhe jo me atë të datës së publikimit të njoftimit për kontratë sic edhe është argumentuar nga AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Edhe këtu, Autoriteti Kontraktues ka mundur të thirret në nenin 72 të LPP-së, duke kërkuar kështu sqarime/dokumentacion shtesë konform rregullave dhe dispozitave ligjore që përfshin kjo dispozitë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një Kamion Auto Kran ku në bazë të Dokumentit të Qarkullimit shihet qartë se Kamioni nuk është i regjistruar fare nga data 07.11.2019 (shiko 5. Lista e Automjeteve fq.14), pPaneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues e vlerëson pretendimin si të pabazuar. Pas dorëzimit të letrës standarde të kërkesës për sqarim të tenderit drejtuar OE të rekomanduar për kontratë, ky i fundit ka dërguar policën e sigurimit të automjetit me numër regjistrimi 01-143-GT brenda afatave ligjore të parapara me LPP. Duke marrë parasysh faktin që OE ankues përmend argumente shtesë rreth validitetit të policës së sigurimit, dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, mbetet nën diskrecionin dhe përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues të verifikojë dokumentin në fjalë dhe të sigurohet rreth përmbajtjes dhe afatave kohore të lëshimit të këtij dokumenti.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues për kontratën mbi qiranë për makinë shpimi të datës 19.05.2020, ku OE i rekomanduar për kontratë në nenin 1 të kësaj kontrate ka përshkruar se qiradhënësi i bart qiramarrësit në shfrytëzim Kamionin kiper dhe Makinën e përdorur për shpim horizontal dhe kompresor Ajri , ndersa tek nenin 2 i të njejtën kontratë thuhet se afati i shfrytëzimit të makinës shpimi rrjedh nga data 19.05.2019, ndësa kontrata është lidhur më datën 19.05.2020. Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton që një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo, për faktin që data e nënshkrimit të marrevëshjes përfshin periudhën e fushëveprimit të aktivitetit të prokurimit nënshkruar nga palët, gjegjësisht qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet që lista e pajisjeve nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është nënshkruar po vetëm vulosur, përkundër kërkesave të AK-së që një listë e tillë duhet nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ofertues. Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi është i bazuar. Pjesa 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në FDT përmend decidivisht që Dëshmia 3 – Lista e pajisjeve duhet nënshkruar dhe vulosur.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se më poshtë, të paraqitura kronologjikisht janë pretendimet ankimore të përmendura në ankesën e OE “Risamont ShPK; Gafa Construction SHPK”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ku thuhet nga AK se deklarata nën betim e anëtarit të Konzorciumit tuaj nuk është plotësuar sipas RRUOPP, dhe ka mangësi në plotësimin e saj duke rezultuar kështu në eliminim të OE ankues. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është pjesërisht i pabazuar. Marrëveshja e konzorciumit e plotësuar nga grupi i operatorëve ekonomik ankues përmban informatat esensiale të këtij aktiviteti të prokurimit. Sa i përket deklaratave të nënshkruara nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes apo/edhe deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, Autoriteti Kontraktues ka mundur të kërkojë informata shtesë konform RRUOPP dhe nenit 72 dhe 59 të LPP-së.

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund të kërkojnë informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Mund të kërkojnë informata sqaruese	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Mund të kërkojnë informata sqaruese	Kusht administrativ

Lidhur me pretendimin ankimor ku Autoriteti Kontraktues thuhet që mungojnë dëshmitë për kompresor për thyerje të pjesëve të forta beton asfalt, dhe nuk janë në bazë të kërkesave të AK. Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë mbetet nën diskrecionin e AK që të vlerësojë validitetin dhe fushëveprimin e dëshmive dokumentare. Duke marrë parasysh kualitetin e dobët të dëshmive dokumentare (shih dudin e referuar më poshtë), rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të kërkojë dëshmi konform nenit 72 të LPP-së të cilat mund të vlerësohen konform kërkesave dhe nuk lënë hapësirë për keqinterpretim të dokumenteve të tilla.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Autoriteti Kontraktues thotë që grupit të OE ankues iu mungon burgia hidraulike, dhe si dokumente përcjellëse kanë vendosur një faturë dhe një dëshmi të një burgie të thjeshtë që nuk plotëson kërkesat e AK-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Marrëveshja për bashkëpunim në mes të OE “Risamont ShPK” dhe “N.SH Hilti” përmban një burgi të thjeshtë e cila nuk përkon me kërkesat e AK pasi që si fushëveprim ka përdorim tjetër. Sa i përket dy marrëveshjeve të tjera me “N.SH Raketa” dhe me “Tali SHPK”, mbetet nën diskrecionin e AK të vlerësojë që pajisjet e dorëzuara dhe dokumentet e tyre mbështetëse a janë konform

kërkesave të dosjes.

Lidhur me pretendimin ankimor ku Autoriteti Kontraktues thotë që grupit të OE ankues i mungojnë dëshmitë për cilindër për ngjeshje, një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar. Paneli shqyrtues konform ekspertitit shqyrtues konstaton, se sa i përket cilindrit për ngjeshje, grupi i OE ekonomik ka listuar këtë pajisje në marrëveshjen e bashkëpunimit me OE "Tali SHPK" por nuk ka ofruar dëshmi dokumentare për pajisjen në vecanti.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ndaj OE të rekomanduar për kontratë ku thuhet që:

1. *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa: 3 Lista e pajisjeve teknike, g) Burgi Hidraulike për shpim vertikal për vendosje te shtyllave min. 1 cope*

Në dëshminë e sjellur nga OE i propozuar për kontratë, përshkrimi i produktit është: Vegla për birime në shkëmb apo tokë me pjesën punuese

Burgj për shtylla elektrike/Digmaq.

Kërkesa e AK ishte "g) Burgi Hidraulike për shpim vertikal për vendosje te shtyllave min 1 cope", ndërsa OE ka ofruar një përshkrim krejt tjetër nga aji i kërkuar nga AK si dhe ka ofruar disa foto të mara nga interneti. (ANEXI 6 dhe ANEXI 7)

Paneli shqyrtues konform ekspertitit shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është i pabazuar pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ekziston dëshmia dokumentare (DUD) e cila përshkruan llojin dhe fushëveprimin e pajisjes në fjalë konform kërksave të AK-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ndaj OE të rekomanduar për kontratë ku thuhet që:

2. *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 3 Lista e pajisjeve teknike, Cilindër për ngjeshjen (min 1 cope)*

Mungon dëshmia e transaksionit bankarë, apo e DUD-it doganorë që e vërteton se cilindri është në pronësi të shitësit, gjithashtu mungon edhe transaksioni bankarë që e dëshmon se pajisja është blerë nga blerësi, respektivisht nga OE i propozuar për kontratë (ANEXI 8)

Paneli shqyrtues konform ekspertitit shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi që për pajisjen në fjalë ekziston fatura me përshkrim konform kërkesave të pajisjes në fjalë. Në rast të paqartësive rreth pronësisë së pajisjes, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të kërkojë dokumente mbështetëse konform dispozitave ligjore në fuqi.

Paneli shqyrtues vjen në perfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së, kriteri kryesor vlerësimit, andaj me rasti e Rivlersimit AK është i obliguar që

ekzaminimin, vlersimin dhe krahasimin e ofertave ta bej në pajtim me nenin 59 të LPP-së, duke e respektuar edhe nenin 60 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna Lipjan,
- 1x1 OE -"FGE Elektro SHPK & NTP Toni-Goni" – Lipjan,
- 1x1 OE "BM Group Sh.p.k" – Prishtinë,
- 1x1 OE "Risamont SHPK: Gafa Constructium SHPK" – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së,
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.